Njoftojmë shpërndarësit tanë të dashur se mund të marrin informacione nga dy faqe interneti të kompanisë sonë. Njëra faqe interneti "www.flpseeu.com" është faqja kompanisë së vendit tonë, nëpërmjet të cilës mund të arrihen magazinat e vendit tonë. Kodet për të hyrë në këtë faqe dhe për të bërë blerje mund t'i kërkonit në zyrat tona. Në këtë faqe numrat aktual dhe të mëparshëm të revistës Forever mund të hapen me fjalëkalimin "forever", kurse fotogaleria me fjalëkalimin "success". Faqja kryesore e internetit të kompanisë, apo siç quhet zakonisht "faqja amerikane" – "www.foreverliving.com" – përmban informacione rreth lajmeve nga FLP-ja, kontaktimeve ndërkombëtare, si dhe rezultateve të pikëve ditore të punonjësve. Në këtë adresë mund të hyjnë gjithë të interesuarit. Në faqen e distributorit mund të hyni duke klikuar mbi „distributor login“. Emri

i përdoruesit është numri juaj i distributorit (pa shenjat e ndarjes). Fjalëkalimi gjendet në fund të llogarisë suaj muajore.

I lutemi Shpërndarësve tanë të nderuar, që në të ardhmen ti kushtojnë kujdes plotësimi të saktë të porosisve të produkteve dhe të formularëve të tjerë! Porositë e produkteve të korrigjuara (emri i porosisë) dhe të panënshkruara, me qëllimin për të shmangur gabimet, nuk mund ti pranojmë. Ju lutemi gjithashtu, të kujdeseni për plotësimin e saktë dhe të lexueshëm të formularëve të regjistrimit: me shkronja shtypi, me bojë të zezë ose blu. Në rastin e ndryshimit të adresës apo të emrit, ju lutemi të përdorni formularin e ndryshimit të të dhënave!

Në interes të sigurisë së çështjeve financiare ju lutemi, që në rastin e paraqitjes së bonuseve nëpërmjet të besuarit për këtë, ky person i besuar të sjell me vete edhe letërnjoftimin e tij! Sipas politikës ndërkombëtare të biznesit, çdo shpërndarës, që nënshkruan formularin e regjistrimit (kontratën), fiton të drejtën e blerjes së produkteve me çmim shumice, direkt nga zyrat. Gjithashtu, shpërndarës i regjistruar, ai bëhet vetëm gjatë blerjes së parë, duke paraqitur kopjen e dytë të formularit të regjistrimit së plotësuar më parë dhe dokumentin e porosisë së produktit të plotësuar.

E parregullt:

Asnjëherë mos blini ose shisni produkte në kanale të tjera elektronike apo njësi të shitjes me pakicë. Duke marrë parasysh mundësitë e ndryshme të shitjes nëpërmjet medias elektronike, sipas Forever Living Products: këto konsiderohen si njësi të shitjes me pakicë. Sipas politikës aktuale të biznesit qarkullimi i produkteve, ose publikimi i formularëve të FLP-s në njësitë e shitjes me pakicë është rreptësisht i ndaluar. Qarkullimi i produkteve me anë të medias elektronike mund të bëhet vetëm nëpërmjet faqes së internetit www.flpseeu.com. I njoftojmë që dorëzimi i kontratave pa autorizim është i parregullt, pranojmë vetëm kontratat me nënshkrim personal! Çdo nënshkrim tjetër konsiderohet si fallcifikim dokumentash!

Risponsorizim!

Dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen për rregullat e "risponsorizimit" të cilat gjenden në kapitullin e 12-të të Politikës së Biznesit. E rëndësishme është se risponsorizimi s'është proces automatik, por vjen në fuqi vetëm pas plotësimi të formularëve të përcaktuar (deklarata e risponsorizimit, fletë regjistrimi e re) dhe përgjigjes së kushteve. Në lidhje me rregullat e Politikës së Biznesit gabon ai që bashkëpunonjësit distributor të regjistruar njëherë i fut për herë të dytë pa plotësuar procesin e risponsorizimit.



NJOFTIMET E ZYRAVE TË HUNGARISË



- Zyra qendrore e Budapestit:
1067 Budapest, Szondi utca 34., tel: +36-1-269-5370.
- Magazina e Budapestit:
1183 Budapest, Nefelejcs u. 9-11., tel: +36-1-291-8995.
Drejtori i tregëtisë: Dr. Gothárd Csaba
- Zyra e Debrececit:
4024 Debrecen, Szent Anna u. 31., tel: +36-52-349-657.
Drejtori i rajonit: Pósa Kálmán.
- Zyra e Szegedit:
6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25., tel: +36-62-425-505.
Drejtori i rajonit: Radóczy Tibor
- Zyra e Szekesfehervarit:
8000 Székesfehérvár, Sóstói út 3., tel: +36-22-333-167.
Drejtori i rajonit: Földi Attila

Produktet e Forever Living Products dalin në treg me rekomandimin e Shoqatës së Mjekësisë Popullore të Hungarisë.

I lutemi Distributorëve të nderuar, që bashkë me formularin e tyre të regjistrimit të dorëzojnë edhe kopjen e lishencës së tyre, si dhe kopjen e dokumentit të paraqitjes së Zyrës së Taksave dhe Tatimeve të ndërmarrjeve. Ata partnerë të Hungarisë, të cilët për blerjet e bëra dëshirojnë të nxjerrin llogari në emrin e ndërmarrjes së tyre personale, mund ta bëjnë këtë vetëm në rast se dërgojnë dokumentet e duhura të plotësuara, dhe një kopje të dokumentit që vërteton pozitën e tij si pronar i ndërmarrjes. Njoftimi, që ka të bëjë me këtë, është i nxjerrë në zyrat tona, por kolegët tanë mund t'ju njoftojnë edhe me fjalë në këtë aspekt.

Njoftim rreth mundësisë së blerjes me ulje
Për të përdorur mundësinë e blerjes me ulje ju lutemi zbatoni rregullat e mëposhtme:

1. **Deklarata:** Ju lutemi që me vëmendje plotësoni saktësisht çdo pjesë të deklaratës. Nëse e dërgoni personalisht kolegët tanë i kontrollojnë të dhënat, por nëse e dërgoni me postë kjo gjë nuk është e mundur, prandaj ju lutemi që me një vëmendje të madhe kontrolloni të dhënat tuaja, sepse në rast gabimi sistemi i uljes së çmimeve nuk hyn në fuqi.
2. **Blerja:** Gjatë blerjes sistemi i ofron shumën maksimale të uljes atyre që e plotësojnë deklaratën. Blerja do të thotë përdorimin e uljes së çmimeve ose pagesën e bonusave, kështu edhe blerja

personale kërkon letërnjoftim me fotografi. Në rastin e blerjes si grup duhet të sillni autorizim të nënshkruar nga dy dëshmitarë të rregullt nga çdo person, për çdo porosi. Kolegët tanë i pranojnë porositë vetëm pasi i kanë kontrolluar këto gjëra. Në rastin e personave me deklaratë mungesa e letërnjoftimit apo e autorizimit sjell refuzimin e porosisë!

3. **Informimi:** Kolegët tanë nëpër magazina vetëm pas paraqitjes së letërnjoftimit me fotografi dhe dorëzimit të autorizimeve japin informacione rreth shumës aktuale të uljes.

Bashkëpunojësit me deklaratë dhe që i marrin bonusat e tyre në formë kuponash, mund të informohen rreth shumave të sakta në adresën Budapest, Szondi u. 34.

Dëshiroj t'u thërras vëmendjen distributorëve të Hungarisë për shërbimin tonë të transportimit të pakove. Me anë të këtij shërbimi Distributori tanë të nderuar i marrin porositë e bëra maksimum brenda 2 ditëve – me përputhje kohe – në çdo pikë të vendit, të cilat duhen marrë brenda 48 orëve, pasi në rast të kundërt ato i anulohet dhe pikët i zbrisim. Çmimi i produkteve të porositura dhe ai i transportit duhet paguar kur pakoja merret në dorë. Në rastin e blerjes me vlerë mbi 1 pikë shpenzimet e transportit paguhen nga kompania.

Porositë tuaja mund t'i bëni në mënyrën e mëposhtme:
– në telefon, ku punonjësi ynë ju jep informacione të sakta rreth shumës së porosisë, vlerës së saj në pikë dhe çmimit të transportit. Numrat e telefonit: 061-297-5538, 061-297-5539, cel: 0620/456-8141, 0620/456-8149
– nëpërmjet internetit në adresën www.flpshop.hu,
– me sms në numrin e telefonit 0620-478-4732.

Njoftimet e Szirakit:

Hoteli Kështjella e Szirakit, 3044 Szirák, Petőfi u. 26.
Tel: +36-32-485-300, fax: +36-32-485-285
Drejtorja e hotelit: Király Katalin

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek:

Dr. Kassai Gabriella	20/234-2925
Dr. Kozma Brigitta	20/261-3626
Dr. Mezósi László	20/251-9989
Dr. Németh Endre	30/218-9004
Siklósné dr. Révész Edit	20/255-2122



NJOFTIMET E ZYRAVE TË SERBISË

- Zyra e Beogradit: 11000 Beograd, Kumodraska 162, tel.: +381-11-3970-127. Orari i hapjes: të hënën, të martën dhe të enjten 12.00-19.30, të mërkurën dhe të premten 9.00-16.30.
- Zyra e Nisit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 13/1., tel.: +381-18-514-130, +381-18-514-131. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 11.00-19.00, në ditët e tjera të punës 9.00-17.00.
- Zyra e Horgosit: 24410 Horgoš, Bartok Béla 80. tel.: +381-24-792-195. Orari i hapjes në ditët e punës: 8.00 - 16.00. Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.

– Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme: bërje porosish në telefon - Telecenter. Numri i telefonit: 011/309-6382. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12:00-19.30, në ditët e tjera të punës 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit dhe paguhet kur merret në dorë.

- Shpenzimet e postës paguhen sipas kursit të PTT Serbisë të ditës që ndodh shërbimi, por FLP-ja e Beogradit i paguan vetëm nëse porosia e bërë në një numër kodit e kalon 1 pikë krediti.
- Nuk mund të bëhet hyrje nëpërmjet telefonit.
- Porositë telefonike merren në shqyrtim deri në datën 25 të muajit, pas kësaj date mund të porosini vetëm personalisht në zyrën tonë.
- Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash dhe gjithë llojet e formularëve. Distributorët tanë mund të blejnë edhe fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Serbisë:

Dr. Biserka Lazarević dhe Dr. Predrag Lazarević: +381-23-543-318. Ata i presin thirrjet tuaja për konsultim të martën në orën 13.00-16.00 dhe të premten në orën 14.00-16.00. Dr. Božidar Kaurinović të mërkurën dhe të enjten në orën 12-14 pret thirrjet tuaja për konsultime në numrin e telefonit +381-21-636-9575.



NJOFTIMET E ZYRËS SË MALIT TË ZI

- 81000 Podgorica, Serdara Jola Piletića br: 20. tel: +381-081-245-402, tel/fax: +381-081-245-412. Drejtori i rajonit: Aleksandar Dakic

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Malit të Zi:

Dr. Laban Nevenka: +381-69-327-127



NJOFTIMET E ZYRAVE TË BOSNIA-HERCEGOVINËS



Zyra e Bijelinës

- Zyra e Bijelinës: 76300 Bijeljina, Trg D. Mihajlovića 3, tel: +387-55-211-784, +387-55-212-605, fax: +387-55-221-780. Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-17.00.

- Zyra e Banja Lukas: 78 000 Banja Luka, Duško Koščica u. 22., tel.: +387-51-228-280., fax: +387-51-228-288. Drejtori i rajonit: Dr. Slavko Palešic. Orari i hapjes: në ditët e punës 9.00-16.30
- Zyra e Sarajevës: 71000 Sarajevo, Akifa Seremeta do. 10., tel.: +387-33-760-650, +387-33-470-682, fax: +387-33-760-651.. Orari i hapjes: të hënën, të enjten, të premten: 09.00-16.30, të martën, të mërkurën: 12.00-20.00. Në çdo të shtunë të fundit të muajit organizojmë një Ditë Suksesi Mini në zyrën e FLP-s. Drejtori i zyrës: Enra Hadžović Në zyrat e Forever Living Products të Bosnias porositë telefonike mund të bëhen në numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk mund të bëhet nëpërmjet telefonit): +387-55-211-784, Bijelinë dhe +387-33-760-650 Szarajevë.

Njoftim i zyrës së FLP-s së Sarajevës

– Nga shtatori në shërbimin tonë është këshilltarja dhe specialistja mjekje nga Bosnia-Hercegovina Dr. Esmā Nisic, me të cilën mund të kontaktohem në numrin e telefonit: +387-62-367-545 gjatë ditëve të punës në orarin: 18:00 – 21:00.

– Këshilltarja dhe specialistja jonë mjekje çdo të mërkurë mban konsultime në zyrën e Sarajevës në orën 17:00 – 19:30.

– Në rastin e porosisë telefonike pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë krediti, atëherë shpenzimet e transportit paguhen nga distributori.

NJOFTIMET E ZYRAVE TË KROACISË



• Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Trakošćanska 16.ů

Njoftojmë punonjësit dhe konsumatorët tanë se zgjatëm orarin e hapjes së zyrës së FLP-s së Zagrebit: të hënën dhe të enjten: 09:00 - 20:00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09:00 - 17:00. Tel: 01/ 3909 770; Fax: 01/ 3704 814. Porositë telefonike: 01/ 3909 773.

• Zyra e Splitit: 21000 Split. Križine 19. tel.: +385-21-459-262. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00; të martën, të mërkurën, të enjten dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Dr. Molnár László

Porosia telefonike: 01/3909 773. Në rastin e porosive me vlerë më të madhe se 1 pikë krediti, çmimi i transportit paguhet nga FLP-ja. Leksionet rreth produkteve dhe marketingut organizohen të hënën, të martën, të mërkurën dhe të enjten nga ora 17 në zyrën qendrore. Orari i hapjes së qendrës: të hënën dhe të

enjten 12:00 – 20:00, të martën dhe të mërkurën 11:00 – 19:00, dhe të premten 09:00 – 17:00. Takimet mund të lihen në numrin telefonik 01/ 3909 773.

NJOFTIM I RËNDËSISHËM: nga 1 marsi nëse blini produkte me vlerë më të madhe se 1500 kuna, apo përdorni shërbimet e sallorit kozmetik, me kartën tuaj DC mund të paguani edhe me këste (2-3 këste). Shfrytëzoheni mundësinë e blerjes me ulje. Për detajet interesohuni tek sponsori juaj ose tek punonjësit e zyrës.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Kroacisë:

Dr. Ljuba Rauski Naglic: +385-915176510
(në ditët e keqe ndërmjet orës 16.00 dhe 20.00)
Dr. Eugenija Sojat Marencic: +385-915107070



NJOFTIMET E ZYRAVE TË SLLOVENISË

• 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 5., tel: +386-1-562-3640.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.

• Adresa e magazinës së Lendavait: Kolodvorska 14., 9220 Lendava. tel.: +386-2-575-12-70, Fax: +386-2-575-12-71, e-mail: forever.living@siol.net.

Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

Numri i Telecenterit (ku bëhen porositë telefonike) është: 01/563-7501

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Sllovenisë:

Dr. Arbaiter Miran: +386-41420788, Dr. Canzek Olga: +386-41824163



NJOFTIMET E ZYRËS SË SHQIPËRISË

• Shqipëri, Tiranë, Reshit Collaku 96, Villa Forever 36.

Fax: +355 4230 535. Drejtori rajonal: Attila Borbath

Drejtori i zyrës: Xhelo Kijaç, tel: +355-4-230-535.

Kontaktim: në ditët e punës në orarin 09.00-13.00, 16.00-20.00



NJOFTIMET E ZYRËS SË KOSOVËS

• Prishtinë, Rr. Uçk br. 94, tel.: +381-38-240-781, +377-44-503-911.

www.flpseeu.com **FLP TV** në internet

Programi i FLP TV nga 24 korrik deri në 21 gusht 2008

18.00 dhe 06.00	Ëndrra jote është plani ynë: Hyrje në FLP Ëndrra jote është plani ynë: Produktet e FLP-s Ëndrra jote është plani ynë: Mundësia e FLP-s
18.10 dhe 06.10	Gusztí Bodi: Koncert
18.35 dhe 06.35	Rex Maughan: Leksion i titruar
19.05 dhe 07.05	Jozsef Heinbach dhe Dr. Erzsebet Nika: U bëmë senior manager
19.30 dhe 07.30	Pjesa 1: Supervisorë, Assistant m. . .
20.05 dhe 08.05	Pjesa 2: Supervisorë, Assistant m. . .
20.35 dhe 08.35	SAPPHIRE: Kualifikimi i Dr. Sandor Miliesz-it
21.00 dhe 09.00	Regjistrim në konkursin e makijazhit Sonya
21.10 dhe 09.10	Konkursi i makijazhit Sonya
21.50 dhe 09.50	Dr. Istvan Taraczkózy: Mënyrë natyrore jetese - Duaje vetveten
22.05 dhe 10.05	Jozsef Szabo: Ditëlindje
22.30 dhe 10.30	Baby Gabi dhe Roxc 69 + Kualifikime: Koncert
23.40 dhe 11.40	Veronika Lomjanski: Në vrull
23.55 és 11.55	Grupi folklorik i Sarret-it
00.20 dhe 12.20	Dr. Edit Wohmuth dhe Dr. Gyula Wirt: Network marketing si filozofi (sipas nesh)
00.45 dhe 12.45	Zsolt Fekete: Rruga
01.15 dhe 13.15	Stevan Lomjanski: Përse FLP-ja?
01.25 dhe 13.25	Managerë, Managerë drejtues
03.25 dhe 15.25	Melinda Gulyas: Guxim në jetë
03.50 dhe 15.50	Attila Pataki dhe Budapest Pops Orcestra: Koncert
04.25 dhe 16.25	Miklos Berkics: Forever është e ardhmja jote
04.55 dhe 16.55	Emil Tonk: Kurs përgatitor drejtuesish
05.20 dhe 17.20	Dr. Edit Revesz Siklosne: Roli i Aloe Vera-s në ruajtjen e shëndetit
05.45 dhe 17.45	O'Djilla - grupi muzikor cigan serb: Koncert



Zyra e Tiranës

European Rally


Málaga

Spain



26-28 shkurt 2009

KUJDES! Ndryshim



Niveli 3

Plotësoni 80 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- Bileta hyrje në Rally dhe dhuratat e nivelit 1
- 3 netë në hotel
- udhëtimi me avion



Niveli 2

Plotësoni 50 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- Bileta hyrje në Rally dhe dhuratat e nivelit 1
- 3 netë në hotel



Niveli 1

Plotësoni 25 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- Bileta hyrje në Rally dhe mbrëmjen festuese, veshje uniformë Rally dhe dhurata speciale Rally



KUALIFIKIMET E RALLY-T EUROPIAN

1 korrik – 31 tetor

Kushte të reja për kualifikim në çdo nivel:

Sponsorizoni të paktën tre distributor të drejtpërdrejtë (të gjeneratës së parë) të cilët arrijnë nivelin Assistant Supervisor. Bëhuni "aktiv" në çdo muaj të periudhës së kualifikimit.

– Periudha e kualifikimit zgjat nga 1 korrik deri në 31 tetor 2008. Kushtet duhen plotësuar gjatë periudhës së kualifikimit.

– Distributorët e rinj duhet të jenë aktiv në muajin e regjistrimit dhe deri në fund të periudhës së kualifikimit.

– Pikët e vjetra të distributorit (pikët e atyre që hyjnë para periudhës së kualifikimit të Rally-t dhe s'janë akoma Assistant Supervisor) llogariten vetëm në pikët e kualifikimit, por jo në pikët totale, 25, 50, 80.

Momenti i regjistrimit të distributorit është momenti kur të dhënat e Formularit të Regjistrimit futen në sistemin kompjuterik të kompanisë. Shpërblimet nuk mund të shkëmbehen në para. Kualifikimi u përket vetëm distributorëve të rajonit. E rëndësishme është që çdo anëtar skuadre i linjës së poshtme të regjistrohet në shtetin ku banon dhe aty t'i bëjë edhe blerjet. Bileta e Rally-t përmban darkën dhe banketin e të premtës. Çdo distributor mban përgjegjësi për kuptimin e duhur të kushteve të mësipërme. S'ekziston mundësia e trajtimit të veçantë. Për çdo pyetje që keni drejtijuni Drejtorit tuaj gjeneral.



Agnes Nagy Nemes:

Duhet mësuar!

Duhet mësuar. Pemët e dimrit.

Që kanë ngrirë deri në rrënjë.

Duhet mësuar. Retë e verës.

Pyjet e larta deri në qiell.

Duhet mësuar mjalti, arra dhe anija kozmike,

E hëna, e marta, e premija,

fjalët, sepse janë të ëmbla,

duhet mësuar hungarisht dhe në gjuhët e botës,

duhet mësuar gjithçka që shfaqet,

që ndriçon dhe jep shenjë:

Duhet mësuar të dashurosh.

Zhvillimi elementi i jetës sonë!

Edhe historia jonë filloi me produktet. Besoj se edhe e jotja, Lexues i dashur. Punoja pa patur mëshirë për vetveten, nuk merresha me shëndetin, megjithëse organizmi më kundërshtonte me shenja të vogla.



Nëse i përket "mesatares" kështu ndodh edhe me Ty. Nëse jo, atëherë meriton respektin tim, sepse edhe Ti dallove diçka. Ndoshta atë që edhe unë. Ndjeve përgjegjësini. Nëse ke familje, atëherë për të, por ndoshta si një njeri që kërkon vazhdimisht suksesin ëndërron një jetë me vlerë, për të cilën është i domosdoshëm Shëndeti.

Në këtë rast meriton gjithë respektin tim. Por rreth kësaj ndoshta flasim më vonë.

Ishte një ditë e zakonshme e nxehtë vere. Po bëja shërbimin tim në dispeçerin e zjarrfikëseve kur më kërkoi përsëri një djalë i ri nga i cili e pranua dhuratën e natyrës duke thënë: "Ta shohim se çfarë di **ALOE VERA?**". S'ka përsa ta them, ai e dinte atë

që unë nuk e besoja. Që atëherë ia di për faleminderit atij djali, i cili pati besim tek aftësia ime gjykuese. E falenderoj **Zoltan Molnar**-in për faktin që familja ime u njoh me **VEPRËN E REX-IT**.

Në këtë ditë të nxehtë vere kisha tetë vjetë që punoja, dhe si dispeçer kisha një vend të mirë pune. Ndoshta tepër të qetë. Kishte përparësinë e vet. Mund të mësoja dhe të përgatitesha shumë. I thithja si sfungjer gjithë informacionet e reja rreth botës, sidomos rreth informatikës. Tani i shijoj plotësisht favoret e njohurive të siguruara. Pastaj erdhën 48 orët pushim. Kujton se atëherë pushoja?

Ha, ha, ha! "Unë s'jam i tillë!"

E njohur? Po. Cili është i tillë. S'isha i qetë dhe **DËSHIROJA SUKSES**.

"Pa **ZHVILLIM** Jeta s'është Jetë! Sot duhet të jem më shumë nga ç'isha dje, nesër duhet të jem më shumë nga ç'jam sot!"

Natyrisht nuk mendoja vetëm për xhepin, megjithatë ulçra e xhepit s'është më e këndshme se ulçra e stomakut! Zhvillimin duhet ta ndjeja nga qafa e lartë dhe diku nën kafazin e kraharorit.

Ky ishte karburanti! Po të duash mund ta quash **ZHVILLIM PERSONALITETI!** Unë bëja para që atëherë, vetëm që isha vetëm.

"Ujë i vakët"? Kisha tmerr nga kjo! Biznesin tim tradicional e nisa në vitin 1997. Është vit i njohur, apo jo? Sikur ta kisha njohur që atëherë **REX**-in! Merresha me tregëti me shumicë dhe pakicë baterish dhe akumulatorësh. Ndërtova një rrjet të vogël të mirë. Natyrisht ky s'ishte akoma **RRJETI** i vërtetë. Problemi me të ishte se kishte pikë qiellore. Më shumë se 500 shitës dhe 5000 kilometra udhëtim me makinë që vinte me të. Një jetë nomade e vërtetë. Kur

e mendoj tani ishte diçka e lezetshme. I shijova çdo minutë, pasi që atëherë më pëlqente Pavarësia. Por sot e kuptoj pak ndryshe **PAVARËSINË**. Thonë se në çdo 10 biznese të reja vetëm 1-2 e festojnë përvjetorin e 5-të. Unë u përkisja këtyre 1-2 bizneseve, pasi firma ime po mbush vitin e dhejtë. Më ka pëlqyer gjithmonë puna e planifikuar dhe e ndërtuar në mënyrë sistematike. E vërtetë që sot nuk e marr unë flamurin e punës. Më ranë ambiciet. 10 vjet punë e përditshme. Ishte e bukur, ishte e mirë, por ishte e mjaftueshme. Natyrisht mund të pyesësh që **PËRSE?** Pasi po ecte mirë! E vërtetë, por unë kam nevojë për më shumë se kaq. Duhet ta ndjej mirë veten në atë që bëj. Duhet ta pëlqej **STILIN E JETËS** që më ofron puna.

Sot mund të them rreth vetvetes: E gjeta rrugën time! Më parë nuk e kuptoja se ç'do të thotë kjo fjali, hapja sytë kur ma thoshin.

Por si filloi?

Pasi morra informacionet e duhura rreth sistemit marketing, ia kuptova menjëherë thelbin. Më pushtoi menjëherë mendimi i të ardhurave pasive dhe trashëgimisë. Mendova për vajzën time e cila atëherë ishte 2 vjeç. Çfarë pamje të ardhmeje! Mendova. Me punën time mund t'i siguroj të ardhmen. Dhe çfarë të ardhmeje! Dhe atëherë mendoja vetëm për anën materiale. Jam i sigurt se në fillim edhe Ti kështu mendon kur i hedh syrin kësaj mundësie. Në fillim as e kishim idenë se sa shumë mund të na japë **FOREVER**.

Me ne u nisën tre bashkëpunonjësit e mi zjarrfikës, njëri prej të cilëve arriti nivelin e supervisorit.

Atilla Jantner dhe familja e tij. Natyrisht i falenderojmë të tre për punën dhe blerjet e tyre. Ne e arritëm këtë nivel për 53 ditë. Pastaj erdhi procesi i mësimi. Duhet të piqeshim për

arritjen e nivelit të mëpasshëm. Po të nisesh tani, s'është e sigurt që e kupton këtë. As unë nuk e kuptoja, pasi nivelin 8%-ësh e arritëm me vrullin e parë. Faza e mësimi është e para gjatë ndërtimit të biznesit dhe nuk merr fund kurrë. Ashtu si në jetë, nëse jemi të zgjuar mësojmë sa jemi gjallë. Përballohemi me faktin: Duhet t'i përcjellim mëtej njohuritë tona. S'kemi qenë asnjëherë në post drejtuesi, nuk kemi patur rast të mësojmë si drejtohet. Për t'i përcjellë mëtej njohuritë tona, duhet të mësonim nga e para. Libra, kaseta, aktivitete, përdorë të gjithçka që ekzistonte. Ia di për nder linjës sime të sipërme, sidomos **Knisz Edit dhe Peter**-it që më besuan detyrën e shkuarjes së magazinë. Më kujtohet se në çdo rast nisesha për në shtëpi me 4-5 kaseta të cilat i dëgjoja deri në fund. Më pëlqente jeta e studentit.

Në fund të vitit 2004 fati na bashkoi përsëri me miq të vjetër. Me një çift të cilët i njihnim prej 20 vitesh, por jeta na çoi në rrugë të ndryshme. Ata janë **familja Oszbach** nga Dombovari. **Tibi-n dhe Zsuzsi-n** e futën në biznes përvojat me produkte. Kishin një jetë të pashpresë. Një biznes ndërtimi në falimentim e sipër, shkatërrim dhe mungesë shprese. E dija se erdhi koha jonë. Bashkë me nënën time **Sitkei Zoltanne**, e cila ndërkohë nga konsumatore u bë punonjëse, i ftuam Ata në një kurs përgatitor Start, ku morrën vendim pothuajse menjëherë. Zsuzsi e filloi biznesin me zemrën e saj të madhe dhe përvojat e mrekullueshme me produktet. Përparonin si raketë, për 3 muaj me radhë shkoja tek ata 3-4 herë në javë. I mbanim leksionet me besim dhe entuziazëm të madh. Dhe patëm rezultat, nëna për 2 javë, kurse ata për një muaj e gjysëm u bënë supervisor, dhe nëpërmjet kësaj bashkë



me rendimentin tonë ne arritëm nivelin 13%-ësh. S'kam për t'i harruar kurrë fjalët e Zsuzsi-t që tha kur ajo i arriti 25 pikët, por ne na mungonin akoma nga 75 pikët:

"S'ka mundësi! S'duroj dot, po të mos e arrini ju, as ne nuk na duhen!"

Aty e ndjeva se ç'do të thotë me të vërtetë **PUNA NË SKUADËR!**

Pas kësaj mësuam së bashku, nga njëri-tjetri. Konsultime të shumta, biseda që zgjatën deri në natën vonë. Mësum shumë nga ata rreth trajtimit të njerëzve, empatisë, teknikës së komunikimit dhe kryesisht rreth modestisë. Po, i dashur Lexues: rreth **MODESTISË**. E di se çfarë më pëlqen në këtë mundësi? Fakti që këtu për afat të gjatë kohe qëndrojnë vetëm njerëzit modest, kampionët e EGO-s nuk sjellin shumë bereqet. Ose ndryshojnë, ose largohen. Skuadra e Zsuzsi-t dhe Tibi-t filloi të forcohej, 2006-a do të jetë viti ynë, thoshim vazhdimisht!

Morrën **VENDIMIN** serioz dhe natyrisht edhe ne vendosëm. Duam të kapërcejmë nivel. U nis puna. Viti 2006 na solli në skuadër njerëz të shkëlqyer: **Attila dhe Vera Kiss, Evi Labodi, Terike Illes, Marika Kovacsne, Csabi dhe Erika Trefeli, Jozsi Erdős, Bocskai Istvanne Kati, Edit Zarka dhe familja e saj, Valika Böszene**, dhe të tjerët. Për fat të keq nuk mund t'i përmend dot të gjithë, më falni, por ua dimë të gjithëve për nder! U krijua një skuadër e madhe në „Shtetin Somogy”, në zonat Kikorpad, Nagybjom dhe Nagyatad.

U gjallërua banda! Sipas fjalëve të **Marika Kovacsne-s**: „Fluturojnë pikët” Dhe fluturonin me të vërtetë. Mbanim kokën me dorë. Kishte ditë kur mbaheshin në 7-8 vende leksione familjare. Ishte një ekperiencë e mrekullueshme. Skuadra bëri diçka të madhe, secili i arriti qëllimet dhe ne u bëmë manager. Falenderojmë gjithë skuadrën.

Vala e re e madhe e vrullit e arriti skuadrën në vjeshtën e 2006-ës, kur nxënësit dalëngadalë u bënë mjeshtër. Drejtuesit erdhën njëri pas tjetrit. Në fillim **Tibi dhe Zsuzsi**, pastaj **Attila dhe Vera Kiss** arritën 120 pikët. **Evi Labodi** dhe **Terike Illes** e arritën nivelin e managerit në të njëjtën kohë. Kurse **Marika Kovacsne** arriti nivelin 13%-ësh. Natyrisht ata ndiqeshin nga punonjës 8%-ësh. Puna e secilit ishte një vepër e vërtetë heroike, pasi asnjëri nuk kurseu kohë dhe energji.

U krijua **bërthama e skuadrës**.

Puna natyrisht vazhdoi, 2007-a ishte viti i hedhjes së bazave, por lindën edhe rezultate të bukura. Tek ne vazhdoi zgjerimi, ndërkohë që u zhvillua edhe biznesi i kumatës dhe vëllait tim. Kështu lindën supervisor të rinj në skuadrën tonë, **Andi Sitkei Tamasne dhe Tamas Sitkei**.

Edhe Zsuzsi dhe Tibi i hynë punës dhe nisën një „front”

të ri, edhe **Magdika Bodog Istvanne, Loretta Bodog dhe Ani Zag Ernőne** u bënë 8%-ësh. Në skuadrën e Nagybjomit sivjet në janar **Piroska Varga Jozsefnë** u bë supervisorja jonë e re. Njerëz fantastik. Natyrisht në sukses kontribuan edhe shumë të tjerë.

Pa punën në sfond nuk do e bënim dot. Falenderoj në mënyrë të veçantë bashkëshorten time **Timi Sitkei-n**, nënën time **Joli Sitkei Zoltane-n** dhe vjerrën time **Vera Toth Attilane-n**, të cilët e morrëm shumëherë përsipër kujdesin për vajzën time **Zsebi** (Alexandra Sitkei), duke na zëvendësuar ne kur puna ishte e para.

Kjo ishte pra, rruga e triumfit, i dashur Lexues.

E zakonisht apo jo? Vendose vetë!

Unë nuk e konsideroj veten njeri të veçantë, por një gjë është e sigurt: Kam **DËSHIRË** për zhvillim të vazhdueshëm. Ti ke pikësnyime? Shpresoj të kesh! Pa pikësnyime jeta s'është jetë! Nëse edhe Ti kështu e mendon dhe ke dëshirë për të vepruar, atëherë mos hezito! Bashkohu! Më beso, tani nuk mund ta kuptosh se përse bën fjalë **NDJENJA E JETËS FOREVER**. Por po të kesh pak besim tek njeriu i cili të respekton me këtë vepër jete, atëherë do ta provosh. Nuk mund të përshkruhet, duhet përjetuar!!!

Ju falenderojmë: **REX MAUGHAN, JOZSI SZABO, MIKI BERKICS, DR. SANDOR MILESZ** dhe të gjithë ju që guxuat të ëndëroni, dhe që mund t'ju ndjekim.

Suksese të shumta, mësoni dhe zhvillohuni gjatë gjithë jetës.



Zoltan Sitkei dhe Timea Sitkei

Manager

Ditë Sonya

NË RRUGËN NEFELEJCS



Mezi na kujtohet? Këtë s'do e thoja. Punonjësit interesohen vazhdimisht: kur do të jetë tjetra?

Në një ditë të bukur mezi mund të kaloje në korridor, aq shumë njerëz po prisnin të hynin në sallën e madhe Nefi. Karriget e vendosura ndryshe, në skenë karriget kozmetike, krevati i masazhit, vende për përgatitjen e modelit të flokëve dhe majikazhit. Kavalkadi i ngjyrave të paletës Sonya tërhoqi shikimet në tryezën e ndritshme prej qelqi. Pas saj ngriheshin kullat Sonya! Pranë tyre ndodheshin edhe produktet e trajtimit të lëkurës.

Peshqirë me ngjyra, punonjës me bluza Sonya vepronin sa andej-këtej. Kompozimet e bukura të luleve zbukuronin gjithandej, gjë që tregonte se këtu po përgatitej diçka tepër femërore!

Fjalën e hapjes së ditës e mbajti Drejtori Gjeneral **Dr. Sandor Milesz** plot me humor dhe fjalë të dashura të dedikuara rëndësisë së feminitetit.

Strukturën e lëkurës na e bëri të njohur **Dr. Gabriella Kassai** e cila ishte mjekja e parë e regjistruar në kompani, dhe sot mjekja këshilltare e FLP-s, rrjetndërtuese aktive dhe mjekje praktizuese gjithashtu.

Zonja shumë simpatike qëndroi në mënyrë elegante para dëgjuesve të cilët u përpoqën të mbanin shënim çdo fjalë të Doktorshës. Ajo thirri vëmendjen për nevojën ditore të lëngjeve cilësore, tregoi përparësitë e ujit tonë të burimit Sirona i cili mund të blihet në shishe gjysëm litërshe.

Enikó Detar dhe Karoly Rekasi e sollën mes nesh Teatrin! Çifti bashkëshortor i suksesshëm dhe i njohur treguan me humor të bukur

se çfarë dhe si i përdorin Ata produktet. Femrat e pranishme zgjatën kokën që ta shikonin mirë Karoly-in, por edhe meshkujt u pozicionun dhe zunë vend kur panë fustanin prej mëndafshi të Enci-t! Morrëm ide që mund të përdoren mirë në praktikë se si mund të përdoren produktet me efekt dhe duke kursyer kohë. I falenderojmë për "Momentet nga një martesë"!

Përzie pa frikë! Çfarë do të thotë ky titull nëse lektori

është rrjetndërtuesi me vullnet të pabesueshëm dhe që ka arritur suksese të mëdha, mashkulli tërheqës **Miklos Berkics?** Vajza – me leksionin e tij të përgatitur mirë na bëri të njohur përdorimin e paketës së trajtimit të lëkurës Fleur de Jouvence.

Produktet e trajtimit të lëkurës gjatë ditës Prekja e mëndafshit (Sonya skin care) u prezantuan nga një nga zonzushat më të suksesshme, **Gabriella Dominko.** Ajo i përdor rregullisht që nga dalja e tyre këto produkte – kjo duket edhe në lëkurën e saj të bukur. Kishte kërkuar në internet shumiljoshmërinë e përbërësve, kështu që dëgjua një leksion profesionist nga Ajo.


Ç'të reja ka në banjën TËNDE? Pyeti gruaja e drejtorit të Europës **Peter Lenkey: Zsuzsa Lenkey.** Ata kanë shumë produkte pasi rrisin dy djem të vegjël. I përdorin të gjithë produktet, kjo u bë e qartë edhe nga përvojat me produkte që Zsuzsi ndau me ne. Na thirri vëmendjen për rëndësinë dhe rolin e lëndëve bazë natyrore.

A mund të hapet një sallon kozmetike referencë? Tregoi historinë e saj personale specialistja e kozmetikës **Gyöngyvér Meszaros** e cila është pronarja e një salloni kozmetik Sonya me atmosferë mediterrane në Miskolc. Tregoi duke falenderuar se sa shumë e ndihmoi **Dr. Sandor Milesz** dhe si e mbështeti sponsori i saj **Janos Tamas.**

Bye-bye flokë! Titulli është një përhëndetje e vogël, i cili bëri të njohur programet Clean. **Dr. Edit Revesz Siklosne** e vërteton edhe me shembullin e saj personal se mund të arrihet rënie e qëndrueshme nga pesha me përdorimin e duhur të produkteve – por nevojitet ndryshim në mënyrën e jetesës dhe lëvizje. Personaliteti i saj gazmor, i dashur dhe i qeshur i bëri të gjithë për vete.



"Ç'TË REJA KA NË





BANJËN TËNDE?"



Mariann Szeker quhet me meritë nënëmadhe. Tek ajo nuk shihet celulit. E përdor rregullisht Body Kit-in, kështu që lëkura e saj është e lëmuar dhe elastike – me fjalë të tjera e ndjen veten mirën nën lëkurë! Na mësoi se si mund t'i përdorim me efekt produktet tona për zvogëlimin e perimetrit të trupit dhe përmirësimin e konsistencës së lëkurës.

Si mund të kesh 50 kulla Sonya aktive edhe në skuadrën Tënde? Pyeti **Aniko Peterbence** dhe dha edhe përgjigjen, sepse këtë Ajo e ka realizuar. Ju lutem, ajo ka 50 bashkëpunonjës të cilët kanë kullë Sonya dhe nga mbrëmja në mbrëmje tregojnë përdorimin e kozmetikës dekoruese!


Me bashkëpunimin e **Rita Mikola Halmine-s** dimë të orientohemi më lehtë në paletën Sonya. Me ndihmën e shamive me ngjyra u dha këshilla tipave me ngjyrë të ftohtë dhe të ngrohtë. Ishte një leksion interesant dhe i bukur!

Bukuria elegante **Tünde Hajcsik** me dinamizmin e saj të zakonitë na tregoi dhe me shifra vërtetoi se përse ja vlen (shumë!) të blesh kullën Sonya. Morrëm këshilla me vlerë në aspektin se si mund të bëjmë para duke futur në punë kullën.

Agnes Krizso mbylli radhën e leksioneve. Duke u kthyer në kohë na tregoi se nga u nis dhe ku përfundoi me kompaninë FLP. Përlujta, produktet, dashuria e punonjësve dhe respekti për drejtuesit përbënin fjalën e saj.

Pasoi vlerësimi i ditës, dhënia e vërtetimeve, për të cilën drejtuesja e programit **Kata Ungar** iu lut drejtuesit të kompanisë hungareze **Dr. Sandor Milesz-it** që të bënte përmbledhjen e ditës dhe duke u shtrënguar dorën t'u jepte vërtetimet gjithë pjesëmarrësve.

Sollën një pamje të bukur në skenë fituesit e konkursit të makijazhit Sonya, **Anett**



Sonya®
Color Collection



Patuzzi, Helga Megyeri dhe Andrea Koncz Konczne, të cilët na treguan drejtpërdrejt se si u zhvillua konkursi në Arenë.

Dëshiroj të falenderoj mjeshtren e njohur të makijazhit **Agi Horacsek-un** dhe berberen e njohur **Agota Sarkadi-n** për punën spektakolare të bërë gjatë gjithë ditës, si rezultat i të cilës pamë makijazhe dhe modele flokësh tepër të bukur, madje edhe vetë procesin e përgatitjes.

Falenderoj ndihmësit e mi, punonjësit e sallorit Sonya, të cilët formuan një skuadër të vërtetë duke i kushtuar vëmendje çdo lëvizje të njëritjetrit. Na ndihmuan në mënyrë profesionale në përgatitjen e trajtimit të mrekullueshëm të duarve, masazhit freskues, trajtimit të lëkurës dhe makijazhit të bukur.

Nëse nuk e keni vizituar akoma sallonin Sonya ju rekomandoj të mos e lini pa e shfrytëzuar në jetë këtë kënaqësi

që punonjësit specialist mund t'ju japin në trajtimin e duarve, këmbëve, masazhin e trupit, apo trajtimin kozmetik dhe makijazh.

Dëshiroj të shpreh falenderimet e mia për punën e pagabuar të teknikëve të zërit që na siguruan sfondin teknik, punonjësve të restorantit "FOLEJA E SHQIPONJËS" për ushqimet dhe pijet e shijshme të shërbyera gjatë gjithë ditës, stafin pastrues për elasticitetin e tyre, si dhe punonjësit që

ndihmuan rregullimin e sallës. Falenderoj **Valeria Kismarton-in** dhe **Judit Posa-n** për bashkëpunimin e tyre.

Si organizuese e ditës dhe drejtuese e programit dëshiroj të falenderoj për mundësinë që tashmë për herë të 7-të mund të jem pjesëmarrëse e ditës së mrekullueshme Sonya. Faleminderit që mund të jem një prej jush!



Me respekt
Kata Ungar
manager

Botuese: Kompania Forever Living Products, Hungari. • **Redaktoi:** FLP Magyarország Kft. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455 • **Redaktori kryesor:** Dr. Milesz Sándor **Redaktor:** Kismárton Valéria, Petrőczy Zsuzsanna, Milesz Anna Sára, Pósa Judit, Pósa Kálmán, Rókás Sándor • **Përgatitja për shtypje:** Tipofill 2002 kft. **Grafika:** Teszár Richárd, Buzássy Gábor, **Fotograf:** BélaKanyó • **Shtypi:** Veszprémi Nyomda Zrt. U përgatit në 49 250 koje • **Përthyes, redatues:** shqip: Dr. Marsel Nallbani – kroat: Darinka Aničić, Anić Antić Žarko – serb: Tóth-Kása Ottília, Molnár Balázs, Meseldžija Dragana – sloven: Novak Császár Jolanda, Biro 2000 Ljubljana
Për përmbajtjen e artikujve shkruarit mbajnë përgjegjësi! Çdo e drejtë mbrohet!

www.flpseeu.com
FOREVER
SHTYPI



FOREVER  RESORTS



1183 Budapest, rruuga Fonal (*pas depos së rrugës Nefejejs*) Tel: +36-1-291-5474 • Mail: sasfeszek@foreverliving.t-online.hu
Orari i hapjes: çdo ditë 10.00 – 21.00

Drink more aloe!



Pini më shumë aloe!